

VENDIM
Nr. 432, datë 19.7.2023

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 67.21% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË
“TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA-PERIME” SHA, SHKODËR, NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TEK BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të nenit 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 67.21% të aksioneve të shoqërisë “Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime” sh.a., Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama